



VENDIM
Nr.14 Datë 08.02.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË
SHOQËRISË “CABLE SYSTEM” SH.P.K NË AKTIVITETIN E
TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës __.02.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CABLE SYSTEM” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “CABLE SYSTEM” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “CABLE SYSTEM” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
ere.gov.al